



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijeheno / Predato Received / Delivered	18.01	2024	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	No. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSAK	SR1/2024		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1447/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-Kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari - anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1447/2023 të datës 27.11.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me numër protokolli 1280 të datës 24.10.2023 të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.01.2024, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1447/2023 e datës 27.11.2023 e parashtruar nga ankuesi,**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 1280 i datës 24.10.2023 i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.**

**Arsyetim**

Nëpunësi civil (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) i punësuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, në pozitën e punës Zyrtar për Shërbime të Punësimit - Zyra e Punësimit në Pejë, më datë 27.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7106/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.1447/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 1280 të datës 24.10.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 08.12.2023 ka





dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit, ndërsa më datë 14.12.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 7106/2023 të datës 27.11.2023; Vendimin me numër protokoll 1280 të datës 24.10.2023 të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.12.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 14.12.2023; Aktin e Emërimit të ankuesit me numër protokoll 61 të datës 28.12.2017; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit; Akt Emërimit të nëpunëses civile me numër 258-2 të datës 07.05.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Zyrës së Punësimit; Vendimin e KPMSHCK-se me numër protokoll 99/2024 të datës 05.01.2024.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankuesit konstatoi se ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime të Punësimit" në Zyrën e Punësimit në Pejë - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

Si rrjedhojë, ankuesi më datë 27.11.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 1280 të datës 24.10.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, me të cilin vendim nëpunësja civile e cila mban po ashtu pozitën e punës "Zyrtar për Shërbime të Punësimit" është caktuar ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Zyrës së Punësimit në Pejë, për periudhë gjashtë mujore, dhe atë nga data 24.10.2023 deri me datë 24.04.2024.

Në aneksen e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ankuesi pretendon se organi përkatës i punësimit me rastin e emërimit të nëpunëses civile si ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Zyrës së Punësimit në Pejë nuk ka respektuar parimin e meritokracisë, ngase sipas të njëjtit edukimi i tij, përvoja dhe vlerësimi i performancës janë me të larta se ato të nëpunëses civile, Tutje i njëjti kërkon që të ketë rivlerësim të procesit të përzgjedhjes duke u bazuar në meritokraci dhe vlerësim objektiv.

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit analizoi legjislacionin e aplikueshëm në ndërlidhje me çështjen e emërimit të përkohshëm të ushtruesit të detyrës, gjegjësisht dispozitat e Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 35 paragrafit 1 dhe 2 ku përcaktohet se: 1. Në rast se një pozitë e nivelit drejtues brenda strukturës organizative të institucionit mbetet e lirë, nëpunësja/i i nivelit të lartë drejtues e atij institucioni e cakton me vendim ushtruesen/in e detyrës për pozitën e lirë. 2. Në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, ushtruesja/i i detyrës mund të caktohet zyrtarja/imë i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit, dhe si rrjedhojë duke u bazuar në kudrin ligjor si me lartë dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, gjegjësisht Aktit të emërimit me numër protokoll 61 të datës 28.12.2017 me të cilin ka themeluar marrëdhënien e punës ankuesi, si dhe Aktit të emërimit me numër protokoll 258 të datës 07.05.2018 me të cilin ka themeluar marrëdhënien e





punës nëpunësja civile, konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar, ndërsa Vendimi me numër protokoll 1280 i datës 24.10.2023, është i drejt dhe i ligjshëm, ngase sipas dispozitave përkatëse ligjore me të cilat rregullohet çështja e plotësimit të pozitave të lira me ushtrues të përkohshëm të detyrës, është përcaktuar se në rast se një pozite e nivelit drejtuese mbetet e lirë ushtruesi i detyrës mund të caktohet zyrtari me i lartë i kategorisë pasuese, në vartësi të pozitës që caktohet, nga cilado njësi organizative brenda institucionit, ndërsa, sipas shkresave të lëndës rezulton se ashtu sikurse ankuesi edhe nëpunësja civile me Akt Emërim janë të emëruar në pozitë të njëjtë të punës si Zyrtar për Shërbime të Punësimit. Pra, sipas Aktit të emërimit me numër protokoll 61 të datës 28.12.2017 rezulton se ankuesi nuk është duke ushtruar pozitë me të lartë se nëpunësja civile, por pozite të njëjtë me këtë të fundit, ndërsa ligji në fuqi nuk ka parapa kriteret tjera përveç nivelit të pozicionit të punës, ashtu që Vendimi me numër protokoll 1280 i datës 24.10.2023 për emërimin e nëpunësës civile në pozitën e Udhëheqësit të Zyrës së Punësimit në Pejë nuk bie ndesh me nenin 35 të Ligji Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, vlerëson se Vendimi me numër protokoll 1280 i datës 24.10.2023, i cili është kontestuar nga ankuesi, është në pajtueshmëri edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti është nxjerr nga organi kompetent, gjegjësisht zyrtari kryesor administrativ dhe i përmban të gjitha elementet e aktit administrativ të shkruar si: pjesën hyrëse, pjesën urdhëruese (dispozitivin), pjesën arsyetuese, dhe pjesën përmbyllëse.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1447/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit,
- Drejtoreshës së Përgjithshme të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë për Burime Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.